



KONFERENCË STUDENTORE

KSFE - 2020

Tema	GURUTË E CILËSISË DHE KONTRIBUTI I TYRE
Vendi i organizimit	Salla 129, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti "Fan S. Noli" Korçë
Data e organizimit	8 Prill 2020
Pjesëmarrja	KSFE – 2020 ju ofron mundësinë studentëve të programeve të studimit Master Profesional , si dhe studentëve të vitit të dytë dhe të tretë, të programeve të studimit Bachelor , në Universitetin "Fan S. Noli", të paraqesin punimet e tyre dhe të diskutojnë idetë e tyre me studentë të tjerë brenda dhe jashtë disiplinave të tyre të veçanta. Pjesëmarrja në KSFE – 2020 është falas.
Qëllimi	Cilësia është elementi kryesor i suksesit të çdo organizate. Një kontribut të rëndësishëm në mënyrën se si organizatat e shohin cilësinë dhe arrijnë cilësinë kanë dhënë pionierët e cilësisë. Të njohur si Gurutë e Cilësisë, ata kanë themeluar dhe profilizuar tendencat filozofike në cilësi. Qëllimi kryesor i KSFE - 2020 është të diskutojë në lidhje me rolet kryesore të guruve cilësisë, si Deming, Crosby, Juran, Feigenbaum, Ishikawa, dhe të tjerët në përmirësimin e cilësisë jo vetëm tek bizneset, por tek të gjitha organizatat përfshirë ato qeveritare, ushtarake, të kujdesit shëndetësor, dhe shumë të tjera.
Organizimi	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti "Fan S. Noli" Korçë
Përfitimet	Të gjithë studentët që do të prezantojnë në KSFE - 2020 punimet e tyre do të marrin një Certifikatë pjesëmarrjeje në KSFE-2020. Tre punimet më të mira do të publikohen në numrin e dytë të revistës së FE, Studime Ekonomike, në një pjesë të veçantë dedikuar konferencës.
Çmime	Komiteti Shkencor i KSFE-2020 do të zgjedhë punimin më të mirë midis të gjithë pjesëmarrësve dhe do t'i dorëzojë autorëve një Certifikatë si "Punimi më i mirë në KSFE - 2020".